

Skënder (Sali) Kuqi

(1954, shqiptar nga Lutogllava/Ljutoglava, komuna e Pejës/Peć, ndërmarrës privat)

Përpara vitit 1993, Skënderi punonte si mësues në fshatin e tij të Lutogllavës/Ljutoglava. E kishte edhe shitoren e vet në fshatin Zahaq/Zahać. Në datën **11.07.1998**, nga ora 15:00, përderisa te Skënderi në dyqan qëndronte i afërmi i tij, Qerim Kuqi, kanë hyrë brenda dy persona të armatosur dhe në uniforma kamuflazhi [emri i njërit nga ta është i njohur për FDH]. Flisnin serbisht. E urdhëruan Skënderin që t'i çonte duart lart dhe atëherë e çuan në garazh. U kthyen pas afro tre minutash. Skënderi e startoi *Mercedesin* e tij, pranë tij u ul një nga kërcënuesit, përderisa tjetri u ul në makinë me të cilin kishin ardhur. U nisën në drejtim të Klinës/Klina. Nga ajo ditë, Qazimi kurrë më nuk e kishte takuar Skënderin. Përndryshe, Skënderi ka qenë i ndaluar dhe e mbanin në shtabin e UÇK-së në **Jabllanicë/Jablanica**. Doktor, i cili punonte në spitalin e UÇK-së në fshatin Irzniq/Rznić, e kishte pranuar Skënderin për trajtim në ditën e pacaktuar të muajit korrik të vitit 1998. Ishte i mavijsor nga keqtrajtimi fizik. Edhe në fytyrë i shiheshin shenjat e dhunës. Ka ndërruar jetë në spital nga lëndimet. Trupi i tij u gjet në një pyll në afërsi të Jabllanicës/Jablanica. Në datën 15.07.1998, nipat e Skënderit kanë shkuar në shtabin e UÇK-së për të kërkuar trupin e tij. Pas grindjes së gjatë, ata ia dolën që ta merrnin trupin. E varrosën në varrezat në fshatin Dubovik. Në muajin mars të vitit 2004, ekspertët e Zyrës së UNMIK-ut për Persona të Zhdukur i kanë zhvarrosur mbetjet mortore të Skënderit. Obduksioni ka konstatuar thyerje të shumta të kockave para dhe pas vdekjes.

Burimet: deklarata Z.A.K, FDH-30879; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), Ex.D298.37, FDH-30878; ICTY, IT-04-84 (R. Haradinaj dhe të tjerët), aktgjykimi, 3.04.2008, FDH-27349; FHP, *Haški tribunal, Sudeenje Slobodanu Miloševiću*, XVIII, 345; SMIP, *Teroristički...*, III, 80; USCG KGDH, *Regjistri...*, FDH-8817; KKMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832.

Ramadan (Lan) Ukëhajdaraj

(25.05.1954, shqiptar nga Strellci i Epërm/Gor-

nji Streoc, komuna e Deçanit/Dečani, kamerier, gjashtë fëmijë)

Ramadani me familjen e kanë braktisur fshatin Strellci i Epërm/Gornji Streoc në fillim të muajit maj të vitit 1998. U strehuan te farefisi në Lumbardh/Ljumbarda. Në datën 10.07.1998, bashkëshortja dhe i biri e shoqëruan Ramadanin deri te shtabi i UÇK-së në Gillogjan/Glođane, me qëllim të shkuarjes në Shqipëri për tu furnizuar me armatime. Tri ditë më vonë, familjarët kanë dëgjuar në televizion se Ramadanin e kishin vrarë më **12.07.1998** në vendkallimin kufitar me Shqipërinë, në rajonin e postbllokut ushtarak **Koshare/Košare**. Me kalimin e kohës, bashkëshortja ka mësuar se Ramadanin e kishin varrosur në qytezën e Bajram Currit [Shqipëri]. Pas përfundimit të luftës, ajo e ka marr letrën nga një njeri nga Shqipëria, i cili i shkroi se ai personalisht e kishte varrosur Ramadanin dhe i përshkroi detajet e vendndodhjes së varrit. Ramadani edhe sot prehet në atë vend. Familjarët e vizitojnë varrin e Ramadanit çdo vjet.

Burimi: deklarata Z.U, FDH-17075.

Vllaznim (Avdyl) Jetishi

(10.01.1978, shqiptar nga Brekoci/Brekovac, komuna e Gjakovës/Đakovica, elektrikist, pjesëtar i UÇK-së)

Vllaznimi u regjistrua në Fakultetin Juridik në Prishtinë/Priština, por së shpejti i ndërpreu studimet dhe u punësua në fabrikën *Elektromotori* në Gjakovë/Đakovica. U inkuadrua në UÇK më 5.05.1998, së bashku me vëllain Dukagjinin dhe pesë familjarë të tij. Ishte i angazhuar në transportin e armatimeve nga Shqipëria në Kosovë, që organizohej përmes fshatit **Devë/Deva**. Vllaznimi e ka humbur jetën më **14.07.1998**, gjatë përlshjes me forcat serbe në rajonin e postbllokut kufitar Deva, i cili ka shpërthyer gjatë kthimit të tij nga Shqipëria me një grup luftëtarësh. I afërmi i tij Qazimi vetëm u plagos më këtë rast. Pjesëtarë të UJ-së e kanë çuar trupin e Vllaznimit dhe Qazimin e plagosur në spitalin e Gjakovës/Đakovica. Familjarët kishin përjetuar shumë probleme për të tërhequr trupin e Vllaznimit nga autoritetet